

## STATUTI

Qendra "MuZEH" Lab



"Qendra për zhvillimin e Muzeve, Trashëgimisë dhe Kulturën"

Në mbështetje të Legjislacionit Shqiptar në fuqi ligjt nr. 8788 datë 03-05.2001 "Për organizatat Jofitimprurëse" dhe ligjt nr. 8789 datë 07.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" me vullnet të lirë të themelueses Dorina Subashi është hartuar ky statut i Qendrës për zhvillimin e Muzeve, Trashëgimisë dhe Kulturën [Center for the development of Museums, Heritage and Culture] si vijon:

Ështe krijuar në qytetin Durrës, sot më datën **02.11.2020** (dymjë e njëzet) ditë Hënë, Qendra MuZEH Lab nga shtetaset me këto identitete:

- 1) **DORINA SUBASHI**, atësia Qamil, e datëlindjes 16.04.1982, shtetase shqiptare, lindur në Durrës dhe banuese në Durrës, paisur me Leternjoftimin ID I25416073B
- 2) **INESA SULAJ**, atësia Agim, e datëlindjes 16.03.1995, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, paisur me Leternjoftimin ID J55316060R.

### **NENI 1**

#### *Dispozita hyrëse*

Ky statut përcakton parimet kryesore të organizimit dhe të zhvillimit të aktivitetit të Organizatës Jofitimprurëse me emërtimin Qendra për zhvillimin e Muzeve, Trashëgimisë dhe Kulturën, [Center for the development of Museums, Heritage and Culture] Lab

### **NENI 2**

#### *Forma e organizimit, emri, simboli*

- Emri i organizatës është Qendra për zhvillimin e Muzeve, Trashëgimisë dhe Kulturës, shkurt MuZEH Lab, dhe është organizatë jofitimprurëse kulturore-shoqërore pa antarësi e cila nuk ndjek qëllime politike, tregtare, biznesi, diskriminimi e fetare në formën e "Qendrës".
- Ajo fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në Gjykatën e rrëthit Gjyqësor Tiranë.
- Simboli i saj përmban fjalët MuZEH Lab.
- Qendra ka stemën dhe vulën e saj me emërtimin: **MuZEH Lab**
- Emërtim që do të pasqyrohet në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që do te ketë qendra.

### **NENI 3**

#### *Qëllimi*

Qendra **MuZEH Lab** ka në thelb veprimtari në të mirë dhe interes të publikut, zhvillimin e aktivizimin e të rinjve dhe komunitetit me kulturën dhe përdorimin e disiplinës së muzeologjisë e trashëgimisë kulturore si forma ndërmjetësimi, advokimi, nxitje e ndërveprimi si hallka të zhvillimit e edukimit të shoqërisë. Strategjia e saj fokusohet në përdorimin e disiplinës muzeale dhe trashëgimisë kulturore, me bindjen se përmes tyre rritet e zhvillohet, edukohet, aktivizohet, transformohet e rritet kultura qytetare dhe

në tej shoqëria. Përtej kufinjve të përafrimit të shoqërisë me aspekte të ndryshme të kultures, synohet lidhja dhe aktivizimi qytetar dhe dialogu nga përvoja dhe eksperiencia personale, brenda të cilave përfshihen sektorë të tjerë si trashëgimia kulturore, arkeologjia, artet, turizmi kulturor, kreativiteti, dokumentimi, mbrojtja, ruajtja, digitalizimi dhe edukimi. Qendra synon advokimin e institucioneve muzeale e profesionistëve muzeal dhe përfshirjen e tyre në diskutimeve dhe eksperiencave të tyre me vëtë muzeun, vizitorët, publikun në aktivitete e veprimitari edukative, seminare, diskutime dhe performanca të tjera. Nga ana tjetër synohet ri-përdorimi i arteve dhe artizanateve si elemente bashkëshoqërues të jetës tjetra. Nga ana tjetër synohet ri-aktivizimi i tyre nëpërmjet aktiviteteve edukuese, didaktike dhe performuese. Përtej tyre, synohet krijimi i kontributit të qendrës në krijimin e ekspozitiveve, leksioneve, workshopëve, seminareve, ecjeve tematike (heritage walks), arkeologji eksperimentale dhe ofrimi i programeve edukuese e aktivitete me përfshirje individuale « hands on » ku shoqëria dhe komuniteti janë në fokus të veprimtarisë. Gjithashtu, qendra do të kontribuojë në forma të tjera të arteve vizuale ndaj fotografisë, menaxhimit të trashëgimisë, programeve kulturore dhe ngritje e zhvillim kapacetetesh individuale. Zhvillimi i nëndisiplinave të mësipërme do ti shërbejnë të rindjeve, profesionistëve, individëve ti përdorin me cilësi ndaj qasjes ne fushën e turizmit kulturor.

## NENI 4


### *Fushat e veprimtarisë*

Për të arritur qëllimin e saj, qendra do të kryejë këto aktivitete:

1. Të kontribuojë e inkurajojë individët e profesionistët ndaj përmirësimit e zhvillimit të mëtejshëm të sistemit muzeor; si edhe të forcojë kulturën e njohjes dhe kujdesit ndaj trashëgimisë në shoqëri, komunitet dhe institucionë arsimore.
  2. Zhvillimin e aktiviteteve kulturore, edukative, të trashëgimisë materiale, muzeale dhe jomateriale, do ta zhvillojë sipas këtyre drejtimeve:
    - a) Përmirësim dhe advokim për njohjen dhe praktimin e koncepteve muzeale, trashëgimisë kulturore dhe edukimit,
    - b) Të japë kontribut në organizimin dhe zhvillimin e programeve kulturore, ndërgjegjësuese, edukative për nivele të ndryshme moshore pa diskriminim gjinor, racor, etnik, prejardhje, fetar dhe kulturor për gjithëpërfshirje sociale,
    - c) Të kontribuojë në dijebërje ndaj profesionit të guidave muzeale, edukatorëve muzeal, guidave kulturore, zhvillimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve individëve me interes ndaj kulturës dhe trashëgimisë kulturore,
    - d) Të kontribuojë në krijimin e hapësirave dhe laboratorëve krijues që nxisin: ekspozimin e kulturës materiale, ruajtjen, mbrojtjen, promovimin, rigjallërimin, interpretimin, edukimin, digjitalizimin dhe përcjelljen e vlerave kulturore tek shoqëria dhe komunitetet përreth,
    - e) Të kontribuojë në evidentimin e trashëgimisë jomateriale nëpërmjet aspekteve të storytelling, si laboratorëve që synojnë edukimin, arkeologjinë eksperimentale, argëtimin si forma inovatore ndaj marrjes së dijeve e njohurive dhe zhvillimin e eksperiencave individuale,
    - f) Të kontribuojë në zhvillimin dhe krijimin e hapësirave krijuese dhe në industrinë krijuese, duke përfshirë të rinjtë, nxënës të sistemit arsimor të ulët, të mesëm e të lartë, e vullnetarë si katalizatorë për mbrojtjen, kujdesin dhe përcjelljes së vlerave dhe inovacionit kulturor në shoqëri,

*Shank*

*Y. Slobodkin*

- 
- g) Të nxisë komunitetin të jetë aktor kryesor së ndarjes së kulturës e pasurisë familjare me qendrën dhe të tjerët ndaj krijimit të muzeve e laboratorëve komunitar, në zhvillim të ideve inovatore në çështje të qëndrueshmërisë, barazisë e gjithëpërfshirjes duke e kthyer kështu në qendër komuniteti,
  - h) Të ofrojë ekspertizë në bashkëpunim me muzetë, institucionë kulturore e arsimore në përpilim manualesh edukative ndaj peisazhit kulturor të qyteteve e zonave të tjera,
  - i) Të nxisë pjesmarrjen e gjinisë femërore si një shtysë ndaj orientimit ndaj profesioneve kulturore në të ardhmen,
  - j) Të përgatisë profesionistë të rinj në fushat e muzeologjisë, guidave kulturore, profesionistë dhe ndërmjetës kulturor si aktorë ndikues në shoqëri,
  - k) Të përkthejë manuale, tekste, botime me fokus njohjen dhe përdorimin e tyre në programe shkollore, krijuese dhe ndihmuese ndaj projekteve kulturore shkollore
  - l) Të zhvillojë aktivitete dhe aksione/kauza edukative, kulturore humanitare,
  - m) Të organizojë kurse, verore/dimërore, seminare, intership-e, shkëmbime, e workshopës në bashkëpunim me muzetë, galeri, arkiva, biblioteka, qendra kulturore, institucionale, NGO të ngjashme, institucionale dhe ente kulturore, sisteme arsimore/akademike,
  - n) Të lehtësojë përmirësimin e sektorit muzeal/trashëgimisë/ turizmit kulturor nëpërmjet konsulencave e advokim në këto këto fusha,
  - o) Të ndërmarrë nisma për projekte studimore/edukative në fushat e muzeologjisë, trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor dhe edukimit,
  - p) Të kooperojë dhe bashkëpunojë me Shoqatat Muzeore, Kulturore, Edukuese, Trashëgimisë e Turizmit në Ballkan dhe Evropë, si edhe të parashikojë organizime e takime profesionale me qëllim aplikim në projekte me tematika të përbashketa dhe ngritje kapacitetesh,
  - q) Të kooperojë për zhvillim seminaresh, konferencash e tryezash në përputhje me misionin e statutit.
  - r) Të krijojë rrjete të kulturës tek të rinjtë në përmirësim e përvojave e cilësisë së jetës e kohës së lirë, si edhe mundësinë për angazhim në të ardhmen.
  - s) Tu krijojë komunitetit të mësuesve të shkencave humane largpamësinë dhe angazhimin me aspekte që lidhen drejtpërdrejtë me veprimtarinë kulturore, trashëgiminë, kreativitetin dhe çështjeve të ndryshme në rang europian e më gjërë.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja**

Qendra krijohet me afat të pakufizuar. Përfundimi i veprimtarisë së Qendrës bëhet me vendim të Bordit Drejtues ose me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas kushteve të parashikuara në nenin 44 të ligjit "Për Organizatat Jofitimprurëse". Personaliteti juridik i Qendrës mbaron në ditën kur vendimi i Gjykatës për ç'regjistrimin e saj ka marrë formë të prerë.

**NENI 6**  
**Selia**

Selia e Qendrës, është në Durrës në adresën Lagja 4, Rr. Enver Zazani, banesë e ulët, Kati I, Durrës  
Qendra e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të çelë degë brenda dhe jashtë vendit.




NENI 7

Të ardhurat e Qendrës do të sigurohen nga :

- kontributi fillestari i themelueseve, i përbërë nga një shumë prej 10.000 (dhjetë mijë) lekë të depozituara në llogari të Qendrës, shumë kjo e cila kalon në pronësi ekskluzive të Qendrës nga momenti i regjistrimit të saj në Gjykatë. Themelueset zhvishen nga e drejta e pronësisë së kësaj shume në momentin e përcaktuar më lart;
  - të ardhura dhe financime nga donatorë vendas dhe të huaj;
  - dhurata, ndihma, grante, kontribute dhe sponsorizime nga persona fizike dhe juridikë, vendas dhe të huaj të dhëna pa kushtëzime që nuk bien ndesh me kushtet e këtij statutit;
  - mbledhje publike e fondeve;
  - programet e finançuara nga organizma ndërkombëtarë, organizma dhe institucione e fondacione të huaja e kombëtare, borde lokale, rajonale, kombëtare e ndërkombëtare, zhvillimi i leksioneve, ekspozitave etj;
  - burime të tjera financimi, shprehimisht të lejuara prej ligjeve të Republikës së Shqiperisë. Në çdo rast do të bëhet evidentimi i këtyre mjetave financiare dhe do të hartohet dokumentacioni përkatës sipas ligjeve ne fuqi.

Neni 8

#### *Kriteret e administrimit të pasurisë*

- Administrimi i pasurive të Qendrës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe financiare mbahet bilanc i rregullt që miratohet nga Bordi Drejtues.
  - Qendra ka llogaritë e saj bankare që çelen dhe operojnë sipas urdhërave të Drejtorit Ekzekutiv.
  - Bordi Drejtues dhe donatorët e mundshëm kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shpjegime rreth gjendjes financiare të Qendrës dhe Drejtorit Ekzekutiv me stafin i jepin ato brenda një afati optimal dhe nëse është e nevojshme i shoqërojnë këto shpjegime me fotokopjet e dokumentacionit përkatës.

Neni 9

## *Miratimi i rregullave të brendshme*

Rregulloret e brendshme të Qendrës dhe degëve të saj, ku përcaktohen normat e funksionimit të sektorëve të ndryshëm të Qendrës, raportet me të tretët, etj, hartohen nga stafi në zërthim të Statutit dhe Aktit të Themelimit dhe miratohen nga Bordi Drejtues.

Nenj 10

## *Ndalimi i shpërndarjes së fondeve*

- Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e Qendrës do të përdoren në mënyre ekskluzive për zhvillimin dhe zgjerimin e qëllimit të veprimtarisë së Qendrës.
  - Këto të ardhura do të përdoren per qëllime statutore dhe nuk do t'i shpërndahen themelueses së Qendrës, perveç detyrimeve në formën e pagesave, rrogave, shpërblimeve dhe kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të Qendrës.

•Çdo veprim i kundërt është plotësisht i pavlefshëm dhe organet përgjegjëse mbajnë përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 11  
*Organet drejtuese*

Organet drejtuese të Qendrës janë:

- Bordi Drejtues
- Drejtori Ekzekutiv

Neni 12  
*Bordi drejtues*

Bordi Drejtues përbëhet nga 3 persona fizikë:

Esma Xheraj  
Zarina Toto  
Dorina Xheraj-Subashi

Anëtarët zgjidhen për një periudhë të pakufizuar.

Neni 13  
*Kompetencat e Bordit Drejtues*

Bordi Drejtues përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej tij vendos për:

- Ndryshimin e statutit ;
- Përcakton fushat dhe programin e veprimitarisë së Qendrës dhe degëve të saj ;
- Mbikqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e veprimitarisë;
- Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit;
- Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Qendrës dhe shpenzimet e saj;
- Nxjerr norma për rregullimin e veprimitarisë, organizimit dhe strukturë organizative të Qendrës,
- Zgjedh, emëron dhe shkarkon, anëtarët e organit më të lartë ekzekutiv (drejtorin ekzekutiv);
- Krijon komitete të posaçme si dhe çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në statut;
- Merr vendim për shpërndarjen, bashkimin ose transformimin e Qendrës në një organizatë të një forme tjeter;
- Vendos për krijimin e degëve ose filialeve në rrethe ose jashtë vendit;
- Vendos për zhvillimin e veprimitarisë ekonomike nga Qendra sipas ligjit me qëllim gjenerimin e të ardhurave;
- Miraton aktivitete për mbledhjen e fondeve, sipas nenit 37 të ligjit " Për organizatat Jofitimirurëse";
- Emëron likuiduesit;
- Shqyrton raportin e likuiduesve;
- Vendos për kalimin e pasurive në subjekte të tjera në rast shpërndarje të Qendrës.

**Neni 14**  
*Drejtori Ekzekutiv*

- Drejtori Ekzekutiv është organ individual, i cili përcaktohet në Statut në emërimet e para dhe ka të drejtë rizgjedhje të pakufizuar.
- Drejtore Ekzekutive e qendrës është Dorina Xheraj-Subashki

**Neni 15**  
*Kompetencat e Drejtori Ekzekutiv*

Drejtori Ekzekutiv ka këto kompetenca gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij:

- Administrimin e veprimtarisë së përditshme të Qendrës, në zbatim të statutit, vendimeve të Bordit Drejtues dhe legjislacionit në fuqi;
- Eshtë përfaqësues ligor i Qendrës.
- Realizon dhe ekzekuton programet e vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës;
- Përgatit projektprogramin vjetor të veprimtarive dhe projektbuxhetin e Qendrës, të cilat ia paraqet për miratim Bordit Drejtues dhe më pas kontrollon zbatimin e tyre;
- Lidh kontratat e punës me stafin e Qendrës duke përdorur metodën e konkurimit të hapur e të lirë, sipas kritereve të përcaktuara nga Bordi Drejtues;
- Përfaqëson Qendrën në marrëdhenie me institucione të ndryshme dhe me persona të tretë, brenda dhe jashtë vendit.

**Neni 16**

*Shpërbimi i personave që bëjnë pjesë në organin më të lartë ekzekutiv, i anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe i punonjësve të organizatës joftimprurëse*

Anëtari i organit më të lartë ekzekutiv (drejtori) dhe punonjësit e organizatës joftimprurëse për punën e kryer përfitojnë pagë, shpërblime dhe rimbursim për shpenzimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të tyre.

Anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës, si rregull, ushtrojnë funksionin e tyre pa shpërblim. Në varësi të kushteve, të numrit dhe të kohëzgjatjes së mbledhjeve, qendra mund të rimbursojë shpenzimet dhe të shpërblejë në mënyrë të arsyeshme anëtarët e organit më të lartë drejtues për pjesëmarrjen në mbledhjet e tij. Ata shpërblehen edhe në rastet kur përm bushin detyra të caktuara.

**Neni 17**  
*Rregullat për mbajtjen e mbledhjeve*

- Bordi Drejtues mblidhet të paktën një herë në gjashtë muaj. Mbledhja e Bordit Drejtues thirret me kërkesë të Drejtorit Ekzekutiv ose me kërkesë të më shumë se gjysmës së anëtarëve të Bordit
- Mbledhja njoftohet me shkrim të paktën 7 ditë përpëra duke bërë të ditur datën, orën, vendin e zhvillimit të saj dhe rendin e ditës .



Mbledhja e Bordit Drejtues është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Në mbledhjen e Bordit merr pjesë dhe Drejtori Ekzekutiv, apo persona të tjera të ftuar, pa të drejtë vote. Në raste të veçanta, pjesmarrja mund të jetë edhe në distancë duke përdorur platforma të ndryshme teknologjike për gjithëpërfshirje në pjesmarrje dhe vendimarrje.

**Neni 19**  
*Vendimarrja*

Vendimet e Bordit Drejtues merren me votën pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm të anëtarëve të Bordit. Votimi është i fshehtë, përveç rasteve të veçanta kur Bordi Drejtues mund të vendosë ndryshe duke përdorur votën e deleguar me proxy në email. Çdo vendim i Bordit dhe procesverbalet përkatëse të mbledhjeve nënshkruhen nga Kryetari i Bordit. Një punonjës i stafit, i caktuar nga Drejtori Ekzekutiv kryen detyrën e sekretarit teknik të Bordit Drejtues.

**Neni 20**  
*Përgjegjësia e anëtarëve të organeve drejtuese dhe punonjësve*

Anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive, si dhe punonjësit e organizatës jofitimprurëse nuk përgjigjen për detyrimet e saj ndaj të tretëve, me përashtim të rasteve kur gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, i kanë shkaktuar dëm të tretëve.

**Neni 21**  
*Bashkimi dhe ndarja e Qendrës*

Qendra me propozim të Drejtorit Ekzekutiv dhe miratimin e dhënë nga anëtarët e Bordit Drejtues, për arsyen e lehtësirave që mund të krijohen nga bashkëpunimi gjithmone në të mirë të arritjes së objektivave të Qendrës, mund të bashkohet ose të transformohet me organizata të tjera jofitimprurëse pa anëtarësi. Qendra konsiderohet e shpërndarë me regjistrimin e subjektit të ri.

**Neni 22**  
*Konflikti i interesave dhe marrëveshjet e ndaluara*

Nuk lejohet konflikti i interesave ndërmjet organizatës jofitimprurëse dhe anëtarit të organizatës vendimmarrës, ekzekutiv ose punonjësit të saj. Rastet e konflikteve dhe procedurat e zgjidhjes së tyre parashikohen në akte të tjera ligjore. Marrëveshjet ndërmjet organizatës jofitimprurëse dhe një anëtarit të organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive ose një punonjësi të saj mund të lejohen vetëm nëse ato lidhen për të përbushur një qëllim ose objekt të veprimtarisë së organizatës jofitimprurëse, vetëm nëse janë të drejta dhe në përputhje me vlerën reale të tregut. Këto marrëveshje mund të lejohen vetëm nëse shqyrtohen paraprakisht nga organet drejtuese. Personat e interesuar duhet të përashtohen nga diskutimet dhe votimi për marrëveshjen. Në rast konflikti interesi ose marrëveshje të ndaluar ose të konsumuar dhe

në rast se procedurat e mësipërme nuk janë ndjekur, organizata jo fitimprurëse mund ta anulojë këtë marrëveshje dhe të ngrëjë padi për dëmshpërblim në gjykatë.

**Neni 23**  
*Zgjidhja e konfliktit të interesave*

Çdo anëtar i organit më të lartë vendimmarrës ose ekzekutiv i organizatës jo fitimprurëse duhet të tërhiqet nga shqyrtimi dhe marrja e vendimit për çdo çështje që ai ose familjarët e tij kanë interesa të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ekonomikë ose vetjakë. Çdo transaksion financiar për llogari të organizatës jo fitimprurëse, ndërmjet një anëtarë të organit vendimmarrës, atij ekzekutiv a një punonjësi të organizatës jo fitimprurëse, si dhe një personi tjetër juridik dhe fizik, kur anëtarë i organit vendimmarrës, atij ekzekutiv ose punonjësi i organizatës jo fitimprurëse ka interes financiar, mund të përfundohet vetëm nëse organi më i lartë vendimmarrës e lejon atë dhe nëse ky transaksion përban kushte më të favorshme për organizatën jo fitimprurëse.

**Neni 24**  
*Likuidimi*

- Kur vendoset shpërndarja e Qendrës, Bordi Drejtues cakton një ose disa likuidues të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi asetat, pasuritë dhe përfaqësimin e Qendrës që nga data e emërimit të tyre e deri në përfundim të likuidimit.
- Likuiduesit e kryejnë veprimtarinë e tyre në bazë të nenit 47 të ligjit "Per organizatat jo fitimprurëse" dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.
- Me emërimin e likuiduesit ose të likuiduesve, Drejtori Ekzekutiv nuk ka më funksione.
- Kur shpërndarja e Qendrës vendoset me vullnet të lirë të Bordit Drejtues, ky organ kontrollon dhe miraton përfundimisht procedurat e likuidimit, miraton raportin përfundimtar të likuiduesit dhe i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për ç'regjistrimin e Qendrës. Nëse raporti përfundimtar i likuiduesve nuk miratohet nga Bordi Drejtues shqyrtohet nga Gjykata në prani të palëve. Likuiduesi ose likuiduesit emërohen me vendim të Bordit Drejtues.

**Neni 25**  
*Veprimtaria e likuiduesve*

- Likuiduesi ose likuiduesit, brenda dy muajve nga data e emërimit të tyre thërrret mbledhjen e Bordit Drejtues, të cilat i paraqet raportin mbi gjëndjen financiare të Qendrës, aktivin dhe pasivin e Qendrës, para se të fillojë operacioni i likuidimit.
- Likuiduesi përfaqëson Qendrën dhe ka të gjitha kompetencat e nevojshme për likuidimin e pasivit të saj. Likuiduesi është i autorizuar të paguajë të gjithë kreditorët dhe më pas vlerëson pasurinë e mbetur dhe kujdeset që kjo pasuri të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga statuti.

**Neni 26**  
*Destinimi i pasurisë pas shpërndarjes së Qendrës*

Pasuria e Qendrës pas shpërndarjes së saj do t'u kalojë në mënyrë proporcionale të gjitha organizatave joqeveritare homologe të cilat veprojnë në territorin e Republikës së Shqiperisë dhe kanë objekt të ngjashëm ose fusha veprimtarie të përbashkëta.

*Selaku*

*Talot*

Përjashtim nga ky rregull përbëjnë të gjitha Organizatat me të cilat Qendra ka pasur projekte dhe programe të përbashkëta, të cilave në mënyrë preferenciale u kalon 40% e aktivit.

Neni 27  
*Vullnetarizmi*



Vullnetarizmi është një akt njerëzor që zhvillon tek individi aftësi të reja, ndërkohë që angazhohet në aktivitete e plane të përcaktuara nga Qendra. Vullnetarë të Qendrës mund të bëhet çdo shtetas shqiptar apo i huaj që ka mbushur moshën 18 vjeç, që ka zotësi për të vepruar dhe që pranon statutin e saj. Pranimi i vullnetarëve bëhet në çdo kohë dhe kur përbushen kushtet për një gjë të tillë. Vullnetarizmi në Qendër vërtetohet me certifikatën e anëtarësimit pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit të përpiluar më parë, që lëshohet pas kërkesës dhe pranimit në mbledhjen e Bordit Drejtues, duke u nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv i saj.

Neni 28  
*Dispozita tranzitore*

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin midis anëtarëve të Bordit Drejtues apo me struktura të tjera të Qendrës do të bëhen përpjekje që të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre. Në të kundërt ato do t'i shtrohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky statut u hartua në katër ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike. Pas leximit dhe gjetjes në rregull ai nënshkruhet me vullnet të plotë pa vërejtje nga themeluesja e Qendrës.

THEMELUESE

Dorina SUBASHI

Inesa SULAJ

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ILIRJAN H. ISAJ**



**DATE 23/11/2020  
NR REP 3591**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 23.11.2020, para meje Noter ILIRJAN H. ISAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, BLV"BAJRAM CURRI", NR.25, NR.1, NR.2, Jane te pranishem:

**Dorina Subashi**, atësia Qamil, amësia Semiha, shtetase Shqiptare, lindur në Durrës dhe banues në DURRËS, me adresë Epikadeve 00690227; Nd. 12; H. 1; Ap. 9; Durrës; Durrës; 2025; Durrës, lindur më 16/04/1982, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. personal I25416073B , .

**Inesa Sulaj**, atësia Agim, amësia Enkelejda, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Gjon Nikolle Kazazi, Ndertese Private; Nd. Nr.21; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiakë Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 16/03/1995, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. personal J55316060R , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, statutin e Qendres MuZEH, bashkëlidhur.



Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërrma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.


Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.




**NOTER  
ILIRJAN H. ISAJ**







I<ALB0313721919J55316060R<<<<  
9503168F2109114ALB<<<<<<<<<8  
SULAJ<<INESA<<<<<<<<<<<<



I<ALB0343191564I25416073B<<<<  
8204169F2906025ALB<<<<<<<<<<9  
SUBASHI<<DORINA<<<<<<<<<<<